



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c), nenit 17 dhe 40 paragrafi 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 ,19 paragrafi 19.4 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 17.03.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR VARREZAT,
OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT, RREGULLIMIN DHE
MIRËMBAJTJEN E TYRE 15NR.011-71878 E DATËS 27.11.2018**

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore, ndryshohet dhe plotësohet neni 12 i Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre 15NR.011-71878 e datës 27.11.2018 dhe riformulohet, si në vijim :

Neni 12

Shërbimet e Varrimit

- 1.Komuna e Lipjanit me këtë Rregullore obligohet që brenda mundësive dhe kapaciteteve buxhetore të Komunës t'i subvencionojë shpenzimet për shërbimet e varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Lipjanit.
2. Shërbimet e varrimit do të bëhen konform riteve të komuniteteve fetare dhe dispozitave të Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre .
3. Procedurat e subvencionimit të shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës do të përcaktohen me Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare elektronike të Komunës.

15Nr. 011-15426

Lipjan, më 17. 03. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

